



UDHËZIME RRETH BANIMIT PËR PERSONAT QË JETOJNË NË FINLANDË



Esitteen tilaus:
Työministeriön maahanmuutoasiat/aineistopalvelu
puh. (09) 16006
Mikonkatu 4, 00100 Helsinki

Ympäristöministeriön julkaisut
puh. (09) 19911
Kasarminkatu 25, 00130 Helsinki


Esitteen tuotanto:
Koillisen sosiaalikeskuksen EU-projekti



1. DISA FJALË PËR FINLANDEZËT

Në kulturën finlandeze është e tillë që me njerëz të panjohur nuk hyjnë lehtë në bisedë. Kjo nuk do të thotë se kanë qëndrim me urrejte ndaj të huajve. Finlandezët i respektojnë të tjerët duke mos i penguar ata. Në rast se bëhet fjalë për gjëra të përbashkëta me ndonjë person tjetër atëherë bisedohet me të e nëse jo, atëherë finlandezët pothuajse nuk shoqërohen.


Finlandezëve u pëlqen qetësia. Nëse në mqedise të përbashkëta ose në ballkon bëhet zhurmë atëherë shumë prej finlandezëve e përjetojnë atë si prishje të qetësise shtëpiake.



Në ndërtesë gjatë ditëve të punës duhet mbahet qetësi prej orës 22.00 – 07.00 dhe vikendeve 23.00 – 08.00, kështu që duhet ikur bisedave me zë të lartë, luajtjes/bërjes së muzikës me instrumente si dhe zhurma të tjera. Mbajtja e qetësisë do të thotë se fqiut i mundësohet natë e qetë. Të qëndruarit zgjuar gjatë natës i bën fqinjët të jenë të hidhëruar ndaj atij personi që vazhdimisht pengon.

Nëse mban ndonjë mbrëmje festive do të ishte mirë që fqinjët të njoftohen paraprakisht rrith zgjatjes së mbrëmjes festive.

2. RREGULLAT PËR MBAJTJEN E RENDIT SHTËPIAK



Atëherë, kur çdo banor i respekton rregullat e përbashkëta shtëpiake dhe ato të përgjihshme qytetare, punët do të shkojnë më mbarë. Nëse dikush shkel vazhdimisht rregullat e përbashkëta, atë e percjellin vrejtjet dhe më në fund deri edhe te dëbimi nga banesa. Në qoftë se qiraja paguhet me vonesë, është me rëndësi të njoftohet mënjëherë qiradhënsi, si dhe mos paguarja e qirasë mund të sjellë çështjen deri te dëbimi nga banesa.


3. DHOMAT E BANESËS

Nëse dhoma nuk ajroset mjaft, mund të ndjeni lodhje, dhimbje koke, ethje të lehta, irritime të lëkurës dhe simptome të ndryshme në frymëmarrje, posaqërisht tek fëmijët e vegjël.




Dera e banjos duhet të mbahet e hapur pas përdorimit, ashtu që lagështia të largohet më mirë. Tharja e rrobave

mbrenda në banesë nuk preferohet. Në koridorin e ndërtesës nuk bënë të ajroset asgjë.



Çdo banor mban përgjegjësi rrith mirëmbajtjes dhe pastërtisë të banesës së vet.

Është mirë që stufa të mos përdorët në mënyrë të tepruar, e poashu të kujdesoheni kohë pas kohe rrith frigoriferit me ngrirje të thellë duke e shkrirë akullin që ndodhet në të.



Në radiatorët e nxemjes qendërore është termostati i cili e matë temperaturën e dhomës. Nëse termostati mbulohet p.sh. me perde të trasha (të shpeshta), atëherë termostati nuk funksionon gjë që radiatori nuk nxehë mjaft.

Nëse në shtëpi vëreni insekte dëmtuese, është mirë të sillë tek personeli për mirëmbajtjen e banesave, ashtu që të mos shpërdahen në tërë ndërtesën.

Ballkoni duhet të mbahet i pastërt, por uji drejtë prej qezme nuk mund të përdoret përlarje. Në ballkon nuk bën të shkaktohet pluhuri e as të përdoret skara. Rrobat mund të thahen por nuk bën të vërehen nga jashtë.



Që ajri të jetë i pastërt dhe i freskët, është mirë të pastrohet yndyra dhe pluhuri i ngjitur prej filterit të kapakut dhe ventilatorit të stufës si dhe gypin e ventilatorit të kushinës. Banori duhet të kujdeset që të mos hidhet ndonjë materie e cila mund të blokon kanalizimin e wc-së dhe të kuzhinës.

4. LOKALET E PËRBASHKËTA

Në koridor lëvizjet duhet të jenë të pa zhurmëshme si dhe të mos hedhen mbeturina në të. Në koridor nuk mund të ruhen rraqet/sendet e shtëpisë suaj. Në qilarin e bicikletave mbahen bicikletat dhe karrocat e fëmijëve.



Gjatë mbrëmjeve dera e jashtme mbahet mbyllur. Mbyllja e derës nuk bën të pengohet me gurë apo me shkopinjë sepse përmes saj mund të hyjnë persona të panjohur.



Në qilarin e juaj mund të ruani rraqet/sendet të cilat nuk i përdorni në shtëpi.


SAUNA	PESUTUPA
18-19 IVA HEBEL	8-10 IVAN IVANOVITS
19-20 MATTI MEIKÄÄNEN	12-14 JOHN DOE
20-21 IVAN IVANOVITS	14-16 IVA HEBEL
21-22 SVEN SVENSSON	20-22 MATTI MEIKÄÄNEN

Mbasi që shpesh lindin grindje mbi përdorimin e lajtores së rrobave dhe saunës atëherë për ti ikur asaj duhet që paraprakisht të rezervohet koha për përdorim dhe t'shfrytëzohen vetëm atëherë. Askush nuk dëshiron, që koha e caktuar t'i shfrytëzohet nga dikush tjeter.

5. ZONA RRETH SHTËPISË

Mbeturinat duhet të klasifikohen në qese dhe të hedhen në enët e caktuara. Është mirë të qartësohet çështja, se ku duhet të dërgohen mbeturinat, letrat, materiet e qelqit dhe mbeturinat e metalta si dhe lëndët helmuese.





Automjetet e kanë vendin e vetë për parkim. Ndalohet të parkuarit e automjetit në oborr dhe në trotuar për arsyen që të mos pengohet ardhja e automjeteve në raste urgjente deri tek ndërtesa.

Shkundja e qilimave dhe rrobave të shtratit mund të bëhet në oborr gjatë kohëve të caktuara.


Fëmijët kanë kopshtin e vetë ku pas lojrat se cilë familje ka obligim të kujdeset për lodrat e fëmiut të vet. Nëse prap se prap dikush harron ndonjë lodër në oborr, ajo nuk bënë të mirret e të dërgohet në shtëpi.



Kafshët shtëpiake jashtë shtëpie duhen të mbahen të lidhura. Kafshët nuk bënë të shëtiten në kopshtin e fëmijëve dhe as të pastrohen në lajtore të rrobave ose sauna.

6. SIGURIMI I SHTËPISË

Sigurimi i shtëpisë nuk është obligueshëm, por në raste eventuale ky sigurim i kompenzon dëmet e shkaktuara në orendi. Në dhoma duhet të jetë edhe sinjalizuesi i zjarrit, përndryshe sigurimi nuk i mbulon dëmet e zjarrit. Është mirë që me kohë të sqarohet çështja, se cilën pjesë të sigurimit të shtëpisë qendra sociale mundësishët e kompenzon.



7. BASHKËJETESË E KËNDSHËME MES NESH

Në pranverë dhe vjeshtë organizohen në oborrë aksione punuese ku shpresojmë të gjithë banorët të marrin pjesë në të. Gjatë aksioneve pastrojmë oborrin dhe mjediset e përbashkëta si dhe kujdesemi për bimët. Po në të njëjtën ofrohet rasti që banorët të njoftohen në mes veti.

8. KËSHILLI I BANORËVE

Si zakonisht çdo ndërtesë ka këshillin e banorëve, i cili këshill ka kontakte të rregullta me kryesinë e ndërrmarrjes së banesave ku përcjellë më tej qëndrimet dhe dëshirat e banorëve. Çdo banorë është mirë të merr pjesë në mbledhje të banorëve së ndërtesës. Në mbledhje jipet rasti që të zgjedheni si antar i këshillit të banesës dhe në këtë mënyrë të mund të ndikoni në çështjet që kanë të bëjnë rrëth ndërtesës së juaj. Për çdo probleme eventuale mund t'a njoftoni këshillin e banorëve.



**NUMRA TË TELEFONAVE DHE DISA TË
DHËNA QË DUHET MBAJTUR NË MEND:**

NUMRI I URGJENCËS: 112

POLICIA _____

**SHTËPIA
E SHËNDETIT** _____

**MJEKU
I JUAJ** _____

**MOTRA
MEDICIONALE** _____

**KËSHILLIMORJA
E FËMIJËVE** _____

**QENDRA
PËR HELMIME** _____

**POLIKLINIKA
KUJDESTARE** _____

ÇERDHJA _____

SHKOLLË E CIKLIT TË ULËT _____

SHKOLLË E CIKLIT TË LARTË _____

GJIMNAZI _____

**SHKOLLAT
TJERA** _____

ZYRA E SOCIALIT _____

ENTI I SIGURIMIT SOCIAL (KELA) _____

ENTI I INKUADRIMIT _____

ADMINISTRATORI I BANESAVE _____

PËRGJEGJËSI I BANESËS _____

KRYETARI I KËSHILLIT TË BANESAVE _____
